

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 431 Prot.

Tiranë, më 19.04 2016

VENDIM Nr. 25, datë 13.04.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4 të datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi Raportin e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit "**HEC OSOJË, Bashkia Maliq, Qarku Korçë**"-"FAVINA" SH.P.K., realizuar nga shoqëri i licencuar në arkeologji "AD-STAR" SH.P.K. dhe informacionin e ardhur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe nga Ministria e Mjedisit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit "**HEC OSOJË, Bashkia Maliq, Qarku Korçë**"-"FAVINA" SH.P.K., realizuar nga shoqëri i licencuar në arkeologji "AD-STAR" SH.P.K. dhe informacionin e ardhur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Mjedisit.
2. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Korçë, e cila duhet të depozitohet pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë aktmarrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin, sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO